

ARGUMENTUM

news opinion analysis



EKSKLUZIVE

Ambasadori palestinez në Shqipëri, Z. Sami
Mhanna bën thirrje për Drejtësi dhe Paqe në Gaza:

**NE MERITJMË TË JETOJMË NË
DINJITET SI KOMBET E TJERA!**

- Kur Pushtimi 5-shekullor
serviret si Bashkëjetesë.

- Zgjidhja e vetme
e krizave tona është
federalizimi i Shqipërisë!

- Lindja e Mesme – ku dhe kur
do të jetë më pas?

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Grushti i Dështuar i 15 Korrikut: Triumfi i Erdoğan-it dhe pasojat në Ballkan.

06 OP/ED

- Zgjidhja e vetme e krizave tona është federalizimi i Shqipërisë!
- Prof. Muhaj dhe “Historia e Retushuar”: Kur Pushtimi 5-shekullor serviret si Bashkëjetesë.

11 FOKUS

- Lindja e Mesme – ku dhe kur do të jetë më pas?

13 INTERVISTA

- EKSKLUZIVE/ Ambasadori palestinez në Shqipëri, Z. Sami Mhanna bën thirrje për Drejtësi dhe Paqe në Gaza: Ne meritojmë të jetojmë në dinjitet si kombet e tjera!

19 REALPOLITIK

- Ekuacion gjeopolitik me disa të panjohura. Peshku në det,

tigani në zjarr! Kthesa e madhe amerikane! Trojka europiane franko-gjermano-britanike.

21 POLITIKË

- Hapet grup-kapitulli i fundit BE-Shqipëri.

22 BOTA

- SHBA-ja dhe BE-ja arrijnë marrëveshje për tarifatat doganore.

ENGLISH EDITION

24 INTERVIEW

- “Diplomacy, Not War”: Palestinian Ambassador to Albania Calls for Justice, Peace, and Global Action for Gaza.

29 IN FOCUS

- “This Is Genocide”: Albanian Journalists Call for Urgent Government Action for Gaza.

30 REALPOLITIK

- Geopolitical equation with several unknowns!



Grushti i Dështuar i 15 Korrikut: TRIUMFI I ERDOĞAN-it DHE PASOJAT NË BALLKAN

Më 15 korrik 2016, bota pa me habi një përpjekje dramatike për grusht shteti në Turqi, një ngjarje që tronditi themelet e shtetit dhe la gjurmë të thella në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Avionë luftarakë fluturuan mbi Ankara, tanke bllokuan rrugët kryesore të Stambollit dhe një deklaratë e lexuar në televizionin shtetëror shpalli marrjen e pushtetit nga ushtria. Megjithatë, ajo që nisi si një rebelim i armatosur përfundoi brenda natës si një triumf absolut i presidentit Recep Tayyip Erdoğan.

Çfarë ndodhi në 15 korrik?

Natën e 15 korrikut 2016, një fraksion i ushtrisë turke ndërmori një

tentativë për të marrë kontrollin e shtetit. Tanket u vendosën në rrugët e Stambollit dhe Ankarasë, avionë luftarakë bombarduan ndërtesa shtetërore, përfshirë parlamentin, ndërsa u lexua në TV shtetëror një deklaratë që njoftonte se ushtria kishte marrë pushtetin për të “mbrojtur demokracinë”, ndërsa presidenti Erdoğan reagoi menjëherë duke i bërë thirrje popullit të dalë në rrugë për të mbrojtur institucionet. Qytetarët iu përgjigjën thirrjes dhe përplasjet me ushtrinë u bënë të përgjakshme. Ndërkohë, ndërtesa të rëndësishme si Parlamenti dhe Pallati Presidencial u bombarduan nga ajri. Pas disa

orësh përleshjesh, përpjekja për grusht shteti u shtyp në mëngjesin e 16 korrikut. Si pasojë, mbi 300 persona humbën jetën, mijëra u plagosën dhe filluan arrestime masive ndaj ushtarëve, gjyqtarëve dhe mësuesve të dyshuar për lidhje me lëvizjen e Fethullah Gülen, të cilin qeveria e akuzoi si organizator të grushtit të shtetit.

Nëntë vite pas ngjarjes që tronditi Turqinë dhe botën, grushti i shtetit i 15 korrikut 2016 mbetet ende një nga ngjarjet më të debatuar dhe më të instrumentalizuara në historinë moderne të vendit. Ajo që nisi si një përpjekje për të rrëzuar qeverinë e presidentit Recep Tayyip Erdoğan, përfundoi si një mo-



ment historik që do ta fuqizonte atë më shumë se kurrë më parë. Presidenti Erdoğan doli nga kjo ngjarje jo si një lider që mezi mbi-jetoi, por si udhëheqës i pacenueshëm i një regjimi të ri presidencial, ku kontrolli mbi drejtësinë, ushtrinë, median dhe politikën është i përqendruar në një dorë të vetme. Në emër të luftës kundër “terrorizmit të brendshëm” dhe rrjetit të Fethullah Gülenit, që qeveria e akuzon për organizimin e puçit, ndodhi një spastrim masiv, që përfshiu mijëra gjyqtarë, ushtarakë, akademikë, gazetarë dhe qytetarë të zakonshëm. Turqia u kthye në vendin me më shumë gazetarë të burgosur në botë dhe opozita politike u reduktua në një zë që flet mes frikës dhe censurës. A ishte ky grusht një përpjekje e vërtetë për të rrëzuar pushtetin, apo një skenar i kontrolluar nga vetë pushteti për të krijuar një alibi të re? Kjo pyetje vazhdon të përmendet me zë të ulët në qarqe opozitare dhe analistike, por faktet nuk kanë nevojë për shumë interpretim: çdo diktaturë fillon me një krizë, dhe 15 korriku i dha Erdoğanit atë që ai e quajti vetë “një

dhuratë nga Zoti”.

Brenda natës, qeveria ndërmori ma-sa drastike: mijëra ushtarakë, gjyqtarë, akademikë, mësues, punonjës civilë dhe gazetarë u arrestuan ose u shkarkuan, të akuzuar si pjesë e rrjetit të Fethullah Gülen, klerikut në mërgim në SHBA që u akuzua për organizimin e grushtit.

Në vitin 2017, Erdoğan organizoi një referendum kushtetues që e shndërroi Turqinë nga republikë parlamentare në një republikë presidenciale me kompetenca të jashtëzakonshme për presidentin. Ai tashmë emëron ministrat, gjyqtarët e lartë, drejtuesit e ushtrisë dhe qeveris përmes dekreteve. Parlamenti u dobësua ndjeshëm, ndërsa pavarësia e gjyqësorit u rrëzua në mënyrë sistematike.

Në emër të sigurisë kombëtare, pas 15 korrikut ndodhi një nga spastrimet më të mëdha në historinë e një shteti modern: mbi 150,000 persona u shkarkuan nga pozitat publike, dhe mbi 80,000 u arrestuan. Dhjetëra media u mbyllën dhe Turqia u rendit si një nga vendet me më shumë gazetarë të burgosur në botë.

Grusht i vërtetë apo i kontrolluar?

Një pjesë e madhe e analistëve, brenda dhe jashtë Turqisë, ndajnë dyshime nëse grushti i shtetit ishte plotësisht spontan. Teoritë janë të shumta: Disa mendojnë se grushti ishte i vërtetë, por i dështuar për shkak të organizimit të dobët.

Të tjerë sugjerojnë se qeveria kishte njohuri paraprake dhe e lejoi të ndodhte pjesërisht për ta shfrytëzuar.

Një teori më e fortë e përhapur në qarqe opozitare është se vetë grushti ishte një “ngjarje e kontrolluar”, me qëllim konsolidimin e pushtetit të Erdoğanit.

Megjithatë, pavarësisht natyrës së saktë të grushtit, është e padiskutueshme se pasojat ishin tejet të favorshme për presidentin dhe shkatërrimtare për institucionet demokratike.

Sot, në 2025, Turqia ka një regjim që mban forma zgjedhore, por funksionon si një sistem autoritar i personalizuar. Kontrolli mbi shtetin, drejtësinë, median dhe ushtrinë është pothuajse absolut. Mbi të gjitha, për shumë qytetarë turq, frika ka zëvendësuar shpresën dhe liria është bërë luks.

GRUSHTI QË GODITI DHE BALLKANIN: RASTI I SHQIPËRISË ME "GULENISTËT"

Grushti i dështuar i shtetit në Turqi më 15 korrik 2016 nuk prodhoi pasoja vetëm brenda kufijve të saj. Ai u shndërrua në justifikimin qendror të një fushate transnacionale nga regjimi i Erdoğan për të spastruar, ndjekur dhe izoluar çdo individ apo institucion që dyshohej se kishte lidhje me lëvizjen e Fethullah Gülenit, jo vetëm në Turqi, por edhe jashtë saj.

Ballkani, dhe Shqipëria në veçanti, u përfshinë menjëherë në këtë presion diplomatik dhe kulturor. Në çdo takim zyrtar me autoritetet shqiptare, Ankaraja ka artikulluar qartë kërkesën për të "çrrënjësuar elementët e FETO-s" nga administrata shtetërore, komuniteti mysliman dhe sistemi arsimor shqiptar.

Në fokusin e parë u vendosën institucionet arsimore të lidhura më parë me lëvizjen e Gülenit, të cilat prej vitesh kishin një prani të dukshme në vend, shkolla, kolegje, qendra edukative. Këto u trajtuan si "kështjella ideologjike" të rrezikshme për interesat turke, dhe ndonëse me ndikim të ulët politik real, u shënjestruan si objektiva të lehtë për shantazh diplomatik.

Shqipëria, e kapur midis interesave të veta kombëtare dhe presionit të një partneri të fuqishëm si Turqia, zgjodhi një qëndrim të matur, por jo të pashoqëruar nga veprime konkrete. Përrashtime, mbyllje institucionesh, dhe përpjekje për distancim nga personat me lidhje të mëhershme me fondacionet e frymëzuara nga Güleni, ishin pjesë e kësaj qasjeje.

Megjithatë, Ankaraja ende mbetet e pakënaqur, sidomos lidhur me faktin që në Shqipëri nuk ka pasur një "asimilim" të plotë të personave dhe rrjeteve që ajo i konsideron "gülenistë". Madje, në disa raste, janë shfaqur praktika të hapura ndërhyrjeje në jetën fetare të shqiptarëve.

Rasti më absurd dhe më shqetësues është ai i ndjekjes sistematike të imamëve dhe hoxhallarëve myslimanë në Shqipëri, të cilët janë etiketuar si ithtare të Gülenit, pa asnjë provë konkrete për veprimtari politike apo të dhunshme. Paradoksalisht, këta predikues të Kuranit u kthyen në objektiva të dyshuar të një gjuetie shtrigash të importuar.

A nuk ishin këta të njëjtët hoxhallarë që shpërndanin fjalën e Zotit, predikonin moralin fetar dhe ruanin traditën? Çfarë ndryshoi pas 15 korrikut? Vetëm rendi i prioritetëve ideologjike të një Turqie që, në thelb, e përdori grushtin e shtetit si një trampolinë për një lloj revolucion kulturor me ng-



jyrimë autoritare, të eksportuar më tej në formën e ndikimit diplomatik e fetar në vendet e Ballkanit. Turqia e Erdoğanit kërkon më shumë sesa bashkëpunim ekonomik apo diplomatik: kërkon konformitet ideologjik. Dhe Shqipëria me ndjeshmëritë e saj fetare, shtetërore e historike gjendet në një pozitë të brishtë përballë kësaj tendence.

Një nga episodet më të dukshme të këtij ndikimi politik në jetën fetare të shqiptarëve ndodhi me xhaminë e Namazgjasë në Tiranë, xhaminë më të madhe në Ballkan, financuar nga shteti turk, dhe e ndërtuar për besimtarët myslimanë shqiptarë.

Megjithëse ndërtesa ishte përfunduar dhe pritej prej vitesh të hapej, inaugurimi i saj u bllokua për një kohë të gjatë, në pritje të një vizite të vetë presidentit Erdoğan. Kjo nuk ishte vetëm një çështje protokolli, ishte një sinjal i qartë për kontrollin e narrativës fetare dhe përjashtimin e elementëve "të padëshiruar".

Në ditën e inaugurimit, ndodhi diçka që sfidon logjikën e çdo rregulli fetar e etik, aq më tepër për atë që e karakterizon popullin Shqiptarë: drejtuesit e Komunitetit Mysliman Shqiptar, të cilët u akuzuan më herët si të lidhur me lëvizjen e Gülenit, u përjashtuan nga ceremonia zyrtare, me pëlqimin e heshtur të autoriteteve shqiptare dhe nën diktatin e preferencave politike të Ankarasë.

A nuk është e pabesueshme që një shtëpi e Zotit, ndërtuar për myslimanët shqiptarë, në ditën e hapjes së saj të përjashtojë ata që për vite me radhë e kanë drejtuar dhe ruajtur fenë, duke i lënë jashtë "sofrës" së tyre?!

Kjo ngjarje është shembulli më i qartë i mënyrës sesi, që prej 15 korrikut 2016, ndikimi i Turqisë në Ballkan është shndërruar nga mbështetje tradicionale në ndërhyrje ideologjike, ku feja është mjet për dominim, dhe përkatësia politike është kusht për legjitimitet fetar.

Ndërsa Turqia nderon me krenari dëshmorët e 15 korrikut dhe lavdëron popullin që, me guxim, doli në rrugë për të ndaluar një anarki ushtarake të kontrolluar, duhet të kujtojmë se falë këtij grushti shteti, Erdoğan vazhdon pa ndërprerje rrugëtimin e tij autoritar në krye të Turqisë. Njëkohësisht, duhet të pranojmë se nga kjo ngjarje ka lindur një regjim me fuqi të pakufizuar, ku demokracia shërben vetëm si dekor dhe besimi fetar si mjet politik shtetëror.

Zgjidhja e vetme e krizave tona është federalizimi i Shqipërisë!

Nga Prof.Dr. ENVER BYTYÇI

Shqipëria prej vitesh shkon herë pas here në prag të kaosit. Viti 1997 ishte turpi dhe njëkohësisht prova, se Shqipëria ka problem të madh me unitetin e saj të brendshëm. Jami një shtet unitar me politika mbi 100 vjeçare të ndara e rë përçara. Unifikimin e kemi në kushtetutë e në fakt jemi në luftë të hapur e të heshtur kundër njëri-tjetrit. Aq e thellë është përçarja sa veçmas në dekadën e fundit ajo ka përfshi edhe politikat e politikanët shqiptarë në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi e deri në Serbi. Gjatë kësaj kohe, fatkeqësisht Tirana zyrtare përkrah politikanët pro-serbë e pro-Vuçiq, ndërkohë që lufton me metoda intriguese e djallëzore pjesën tjetër të politikës shqiptare.

Të gjitha fijet e situatave kaotike në këto dhjetë vite e pal më shumë i lëviz vetëm një njeri. Ai është kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Sa herë i duhet të harrohen skandalet, manipulimet, vjedhjet zgjedhore e korruptive, bashkëpunimet e tij e të qeverisë që drejton me mafien dhe krimin e organizuar, ai, pra kryeministri Rama, fabrikon kriza artificiale, të cilat e çojnë Shqipërinë ose pjesë të saj në prag katastrofe. Sa herë i duhet të forcojë pushtetin e tij absolut bëhet vëlla i presidentit të Serbisë, me qëllim që të sigurojë përkrahjen euro-atlantike



në emër të stabilitetit. Kostoja e këtyre aventurave kryeministore është e tmerrshme dhe ajo paguhet prej shqiptarëve, Para së gjithash me shpopullim, por edhe me dëme financiare direkte. E fundmit krizë e stisur nga Edi Rama ishte ajo e Thethit. Ndërkohë shqiptarët rrijnë dhe ankohen. Madje dëgjova në internet një këngë të titulluar “Kush je ti”?, një këngë kjo protestuese e deri kryengritëse ndaj politikave destruktive, diskriminuese dhe poshtëruese të kryeministrit të vendit tonë. Në themel qëndron drama e diskriminimit, një dramë deri në aparteid. Shkak është lufta për pushtet. Madje jo vetëm për pushtet personal, por edhe për pushtet krahinor, selektiv, të shndërruar në sentiment anti një pale tjetër. Në një vend

ku dërgohet ushtria për të shtruar popullin, ai vend ka probleme të mëdha ndarjesh, diskriminimi, hasmërie, urrejtjeje dhe hakmarrjeje. Sa më shumë të qëndrojnë Edi Rama në pushtet, aq më shumë thellohen e do të thellohen këto plagë. Por a do të shërohen këto plagë edhe ditën kur Zoti të mos ia mundësojë Edi Ramës pushtetin absolut mbi shqiptarët?! Mendoj se jo. Në thelb një krizë mosbesimi, urrejtjeje, ndasie e hasmërie ka ekzistuar në çdo kohë. Merrni Nolin dhe shihni sesi i ndan zonat e Shqipërisë me sarkazmën e tij! Se si ai e zhvilloi luftën politike deri te përdorimi i armëve. Po ajo ndodhi në vitin 1997! Asgjë më pak! Ndërsasot të njëjtën gjë si Noli po bën Edi Rama! Limd pyetja: – Si mund të zgjidhet kjo krizë permanente? Çfarë

duhet të bëjmë për t'i dhënë fund këtij konflikti? Në fund të fundit ka një pyetje themelore: – Pse prej kur është shpallur pavarësia e Shqipërisë ajo kurrë nuk pati stabilitet?! A është diktatura e njëshit zgjidhja, siç ishte diktatura e Enver Hoxhës?! Vërtetë jemi kaq të pashpresë për ta bërë Shqipërinë një vend stabil e njëkohësisht demokratik me një shtet të së drejtës?! Skeptikët të thonë se “Ky vend nuk bëhet”! “Patriotët” të thonë se “Atdheu është mbi gjithçka” dhe me këtë kërkojnë që të “respektohet” shteti, pra lideri i radhës, kësaj radhe më brutali i të gjitha kohëve. Të respektohet edhe autoriteti i tij, që do të thotë karakteri unitar i shtetit shqiptar! Në Europë i bien shkurt: – Shqiptarët nuk administrohen nëse nuk kanë një udhëheqës autoritar! Madje e kanë kërkuar me ngulm këtë qasje autoritare të qeverisjes, sepse dikush i ka bindur ata se “shqiptarët e sidomos malësorët janë njerëz të prapë”! Këtë paradigmë kishte për qëllim edhe dhuna në Theth. Kryeministri priste që banorët e Thethit të merrnin armët dhe mediet ndërkombëtare ta mbusheshin me lajme për “egërsinë e malokëve”! Por fatmirësisht nuk ndodhi kjo. Shumë gjatë në kohë kam menduar se cila mund të jetë zgjidhja. Diktatura e një të pashpirti, apo demokracia? Përfundimisht jam i bindur se Shqipëria ka nevojë për t'u bërë një vend federativ në modelin e Austrisë, Gjermanisë ose Zvicrës. Thelbi i konfliktit të ne e kudo në botë është administrimi i territorit. Kush do ta bëjë këtë? Banorët që jetojnë në këto territore, apo kreu i qeverisë sot apo shtetit nesër. Ka gjasa që diktatura kryeministorenë Shqipëri të kthehet në një diktaturë pres-

idenciale. Nëse zgjedhim diktaturën si popull e si komb, atëherë do të përfundojmë minoritarë në vendin tonë, aty ku shqiptarët kanë jetuar den baba den. Do të ketë shpopullim të tmerrshëm dhe të huajt, kryesisht aziatikët, do të jenë shumicë në Shqipërinë e kësaj diktature.

Nëse zgjedhim modelet më të mira të Europës, parasëgjithash atë të Austrisë ose Gjermanisë, pra nëse bëjmë një Shqipëri federale të atij modeli, atëherë qytetarët do të jenë zotër të territoreve të trashëguara nga të parët e tyre. “Patriotët” do të më thonë se “Ti je për shpërbërjen e Shqipërisë”! Në fakt unë jam për forcimin e saj dhe të harmonisë kombëtare. Nuk është modeli i diktaturës që garanton unitarizmin e shtetit shqiptar, unitetin e shqiptarëve. Nuk e garantojnë këtë as preferencat në zgjedhje sipas krahinave dhe ideologjive. Njerëzit duhet të shohin në praktikë e ta prekin qeverisjen. Diktatura e shndërron atë në fasadë. Zgjidhja më e mirë dhe e vetme është që tri ose katër republika në territorin e Shqipërisë të kishin autoritet në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit, planifikimit hapësinor, menaxhimit e resurseve mbi e nëntokësore dhe qeveria qendrore të ishte përgjegjëse për sovranitetin, sigurinë, mbrojtjen, politikën e jashtme dhe planifikimin e strategjive kombëtare të zhvillimit. Nëse Shqipëria do të ishte federative, jo në kuptimin etnik, sepse ajo është homogjene, por në kuptim të decentralizimit, atëherë krizat katastrofike nuk do të përhapeshin nga Himara e deri në Theth. Do të kishim vetëadministrim dhe vetëplanifikim të zhvillimeve urbane, pasurore, ekonomike, financiare.

Në fund të fundit autonomia

ekonomike dhe financiare është thelbi i demokracisë. Si e tillë një Shqipëri federale do të çlironte energji të pakufishme për progres dhe zhvillim. Ndërkohë do të zbehej urrejtja, hasmëria dhe përpjekja për hakmarrje politike dhe të llojeve të tjera në vend. Ne duhet ta pranojmë se Shqipëria përveç konfliktit politik, nuk ka asnjë lloj konflikti tjetër. Dhe konflikti politik është në mjedisin tonë që para shpalljes së pavarësisë. Për ta mundur këtë situatë duhet federalizuar vendi, me qëllim që të decentralizohet fuqia e kontrollit të territorit nga një dorë e vetme. Decentralizimi në kontrollin e territorit largon shkakun themelor të konfliktit politik. Qeveria qendrore do të kishte më pak mundësi dhe shanse të ishte e korruptuar siç ajo është sot. Në rastin e federalizimit qeveritë lokale kontrollohen më mirë nga qytetarët. Llogaridhënia shkon më afër njerëzve të lirë. Interesat politike dhe ato qytetare përafrohen. Mirëqenia dhe të ardhurat rriten nga resurset pasurore dhe menaxhimi i mirë i tyre. Pushteti shkon afër qytetarit dhe interesave të tij. Përfundimisht vjen edhe konkurrenca e zhvillimit midis pjesëve të kësaj federate. Një lëvizje politike civile me kërkesë ndryshimin e kushtetutës për të krijuar një Shqipëri federale është e domozdoshme dhe e vonuar. Nëse partia në pushtet dhe opozita e kundërshtojnë një opsion si ky, atëherë Shqipërisë do t'i vijë një lëvizje politike e tillë me kërkesë absolute krijimin e republikave autonome brenda territorit të saj. Qytetarët e diskriminuar në zona e krahina të ndryshme të vendit nuk do të pranojnë brez pas brezi “të japin mish për Zahrish”!

PROF. MUHAJ DHE “HISTORIA E RETUSHUAR”:

Një reagim ndaj deklaratës së Prof. Dr. Ardian Muhajt mbi “vëllazërinë historike” shqiptaro-turke dhe nevojës për ndershmëri akademike ndaj kujtesës kombëtare.



Nga Marjana DODA

Kur Pushtimi 5-shekullor serviret si Bashkëjetesë



Në kuadër të aktiviteteve përkujtimore për 15 Korrikun, Ditën e Demokracisë dhe Unitetit Kombëtar në Turqi, në Tiranë u mbajt një panel diskutimi me temë “Emri i Fitores: Turqi”, i organizuar nga Drejtoria e Komunikimeve e Presidencës së Turqisë. Ndër panelsitet ishte edhe Prof. Dr. Ardian Muhaj, përfaqësues i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Gjatë fjalës së tij, Prof. Muhaj theksoi se marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe turqve kanë qenë “vëllazërore ndër shekuj”, një deklaratë që, përtej dëshirës për ndërtimin e marrëdhënieve të mira dypalëshe në kohën e sotme, përbën një devijim serioz nga e vërteta historike.

Kjo deklaratë u përforcua edhe nga disa analistë të tjerë pjesëmar-

rës në panel që nenvizuan “bashkejtesen 600-vjeçare”, por kur një historian e thotë këtë publikisht, nuk mund të qëndrojmë në heshtje.

E gjendur në atë sallë, nuk mund të mos habitesha që një deklaratë e tillë vinte nga një profesor i nderuar, akademik dhe, siç e theksoi ai vetë, anëtar i disa akademive brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pas përfundimit të aktivitetit, ia bëra të ditur se ajo që ai deklaroi ishte e pasaktë dhe se, si historian, ai kishte detyrimin të respektonte historinë e Shqipërisë.

Megjithatë, do të doja të shprehja edhe zhgënjimin tim përballë këtyre rasteve, kur profesorë të nderuar, me tituj dhe përfaqësime akademike të rëndësishme, hedhin deklarata që në këndvështrimin tim janë të papërgjegjshme dhe të dëmshme për faktet historike.

Kur flasim për marrëdhëniet tona me Turqinë, vetëdija jonë kolektive priret menjëherë të përqendrohet te raportet e sotme ose ato të dekadave të fundit, duke lënë në hije të kaluarën historike, e cila ka qenë shumë më e ndërlikuar dhe shpeshherë e dhimbshme.

Gjatë shekullit të fundit, Shqipëria dhe Turqia kanë ndërtuar marrëdhënie strategjike dhe bashkëpunim të ndërsjellë, si dy shtete të pavarura, mbi baza të barabarta dhe interesa të përbashkëta. Megjithatë, këto janë zhvillime të kohëve moderne dhe nuk duhet ngatërruar me marrëdhëniet historike mes shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane.

Është e rëndësishme të bëjmë dallimin mes Perandorisë Osmane dhe Republikës së sotme të Turqisë. Janë dy entitete të ndryshme, me sisteme, ideologji dhe qëllime të ndryshme, njëra ishte

pushtuese, tjetra është partnere. Çdo përpjekje për t'i bashkuar këto dy periudha nën një narrativë të vetme "vëllazërore" përbën një falsifikim të qëllimshëm të historisë.

Perandoria Osmane ishte një pushtuese që për pesë shekuj mbajti nën sundim trojet shqiptare. Ajo shtypi kryengritje shqiptare, përçoi politikë të asimilimit, ndaloi gjuhën shqipe dhe pengoi përpjekjet për vetëdije kombëtare. A mund të quhet kjo vëllazëri?

Të thuash sot, nga pozita e një akademiku dhe anëtar i Akademisë së Shkencave, se shqiptarët dhe turqit kanë pasur "lidhje vëllazërore ndër shekuj", është të zëvendësosh historinë me diplomaci, në funksion të interesave të tanishme politike. Kjo nuk mund ti falet një historiani.

Unë nuk jam historiane, por jam ithtare e historisë. Në librat historikë shqiptarë kam mësuar se Perandoria Osmane ishte pushtuesja jonë, që vrau, mori peng që në djep fëmijët shqiptarë për t'i përdorur si ushtarë, jeniçerë, për etjen e saj për pushtet dhe zgjerim.

Kam mësuar gjithashtu se rilindësit shqiptarë u përpoqën me mund dhe sakrifica të mëdha për të ngritur, qoftë edhe një shkollë në gjuhën shqipe. Kjo u bë realitet vetëm në vitin 1887, kur pas më shumë se katër shekuj e gjysmë nën sundimin osman, u hap Mësonjëtorja e parë shqipe në Korçë. Ishte kjo një arritje historike, e realizuar në një kohë kur Perandoria Osmane po hynte në fazën e fundit të ekzistencës së saj, dhe megjithatë, shqiptarëve iu desh të përballen me pengesa të shumta për të siguruar të drejtën themelore për shkollim në gjuhën

amtare.

Kam lexuar dhe ndjerë në vargjet dhe prozat e Rilindasve, se shqiptarët luftuan, sakrifikuan dhe dhanë gjithçka për të patur një shkollë shqipe, një flamur, një gjuhë, një atdhe.

Për çfarë "bashkëjetese" flisni ju, z. Muhaj?

Rilindësit tanë janë dëshmi e gjallë e përpjekjeve të shqiptarëve për liri, për gjuhë, për arsimim, për atdhe. Gjuha shqipe, për të cilën u derdh gjak ndër breza, është shenjtëri kombëtare.

Naum Veqilharxhi, Jeronim De Rada, Kristoforidhi, Zef Jubani, Pashko Vasa, Hasan Tahsini, etj, janë prova se nuk kishim liri, nuk kishim gjuhë, nuk kishim shkollë, sepse osmanët nuk na i lejonin. Këto i kam mësuar në shkollat shqiptare. Në ato libra që, ju Prof. Muhaj dëshironi t'i hidhni në erë me një fjali. Duhet ta kemi të qartë: ajo histori nuk ka penguar kurrë ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha me Republikën e Turqisë, të cilën e njoh si një aleat të rëndësishme strategjike për Shqipërinë, sidomos në rajon.

Por a mundet që një akademik shqiptar, historian, të deklarojë se shqiptarët kanë pasur një bashkëjetese historike me Turqinë, ndërkohë që Shqipëria ka qenë për 500 vjet nën pushtimin osman?

Më shqetëson kjo retorikë e dëmshme, veçanërisht kur vjen nga figura akademike, anëtarë i departamentit të historisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në fakt, historia është një test i rëndësishëm për vetë Akademinë e Shkencave, e cila ende nuk e ka përmbushur misionin e saj. Kjo mungesë reflektimi dhe përgjegjësie institucionale e zbeh

edhe më tej besueshmërinë e saj në sytë e publikut.

Të quash "bashkëjetese" marrëdhënien mes shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane gjatë pesë shekujve pushtim është një keqinterpretim i rëndë historik dhe moral. Pushtimi osman solli me vete kryengritje të njëpasnjëshme për çlirim, nga koha e Skënderbeut deri te lëvizjet e Rilindjes Kombëtare, shtypje të identitetit kombëtar, ndalim të gjuhës shqipe, konvertime të detyruara dhe imponim të një sistemi juridik e fetar të huaj. Shqiptarët shpesh u shfrytëzuan si burim njerëzor për administratën dhe ushtrinë perandorake, por kjo nuk përbën as emancipim, as zhvillim kombëtar.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu figura më e lartë kombëtare e historisë sonë, hero i ynë kombëtar, është njohur si i tillë falë qëndresës dhe betejave të tij kundër Perandorisë Osmane. Ky është një fakt historik i pakontestueshëm. Është e vështirë të thuhet nëse do të kishte luftuar kundër osmanëve nëse do të kishim pasur një bashkëjetese vëllazërore me ta, por realiteti historik është se ai i udhëhoqi shqiptarët në një rezistencë të lavdishme kundër pushtuesit. Një tjetër figurë madhore kombëtare është pa dyshim Ismail Qemali, i cili më 28 nëntor 1912 ngriti flamurin e pavarësisë në Vlorë, duke shpallur ndarjen përfundimtare nga Perandoria Osmane, pushtuesi ynë për pesë shekuj. Asnjë interes personal, politik apo meskin nuk mund ta zhbëjë këtë realitet historik. Kushdo që tenton të rishkruajë, të relativizojë apo të shtrembërojë historinë, është në thelb një tradhtar ndaj

kombit dhe tokës që e ka lindur. Nuk ka emër tjetër për këdo që guxon të artikulojë të pavërteta për këtë çështje, veçse “Kalë Troje” i interesave gjeopolitike të huaja. Pavarësisht se bëhet fjalë për një periudhë 500-vjeçare, e cila përfshinte edhe episode të bashkëpunimit, ngritjes sociale dhe pjesëmarrjes së disa shqiptarëve në administratën osmane, kjo nuk mund të fshijë faktin historik bazë: shqiptarët ishin nën një pushtim të huaj, atë osman. Pushtim që solli me vete ndikime të thella strukturore, madje dhe shkatërruese për kulturën, identitetin dhe vetëvendosjen e popullit shqiptar. Ndryshimi i fesë, ndryshimet në sistemin juridik dhe shoqëror, shpërnguljet, represionet dhe asimilimi janë gjithashtu pjesë e kësaj historie.

Kjo histori e pushtimit osman të trojeve shqiptare është e qartë dhe e dokumentuar, dhe nuk mund të preket, apo të falsifikohet. Sepse kështu, shkelim mbi çdo përpjekje të atyre që ranë për atdhe, për fe, për gjuhë, për liri. Mohojmë ata që dhanë jetën për këtë tokë, mohojmë heroin tonë kombëtare, Skënderbeun, mohojmë Rilindasit, mohojmë Ismail Qemalin mohojmë vetveten. Jo, i nderuar z. Muhaj, ne nuk kemi qenë asnjëherë vëllezër me osmanët apo turqit, as në kontekstin historik të pushtimit, as në raportet që përfaqësojnë realisht historinë tonë. Ne jemi shqiptarë. Dhe asnjë gradë shkencore nuk mund ta zhbëjë këtë të vërtetë historike.

Këtu duhet të bëjmë një ndarje të qartë dhe të sinqertë. Perandoria Osmane ishte një fuqi pushtuese që mbajti nën sundim territoret shqiptare për pesë shekuj. Repub-



Pavarësisht se bëhet fjalë për një periudhë 500-vjeçare, e cila përfshinte edhe episode të bashkëpunimit, ngritjes sociale dhe pjesëmarrjes së disa shqiptarëve në administratën osmane, kjo nuk mund të fshijë faktin historik bazë: shqiptarët ishin nën një pushtim të huaj, atë osman. Pushtim që solli me vete ndikime të thella strukturore, madje dhe shkatërruese për kulturën, identitetin dhe vetëvendosjen e popullit shqiptar.



lika e Turqisë, e formuar në vitin 1923 nga Mustafa Kemal Atatürk, është një shtet i ri, me një identitet tjetër politik, kulturor dhe gjeopolitik.

Marrëdhëniet strategjike mes Shqipërisë dhe Turqisë sot janë reale, të rëndësishme dhe pozitive, por ato nuk mund të shërbejnë si justifikim për të rishkruar ose relativizuar të kaluarën historike.

Këtë vit shënojmë zyrtarisht 102 vite marrëdhënie diplomatike mes Shqipërisë dhe Turqisë, një partneritet që është kthyer në një marrëdhënie të qëndrueshme, strategjike, miqësore dhe të dobishme për të dyja vendet

Por duhet të jemi të qartë: Kjo marrëdhënie, sado e ngushtë të

jetë sot, nuk mund të shërbejë si justifikim për të ndryshuar të kaluarën historike.

Marrëdhëniet e shëndosha midis Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë nuk fillojnë në kohën e Perandorisë Osmane, por pas shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912, shpërbërjes së Perandorisë dhe krijimit të një rendi të ri ndërkombëtar.

Turqia sot është një aleat i rëndësishëm strategjik për Shqipërinë, sidomos në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik. Në këtë këndvështrim, dua të theksoj rolin e padiskutueshëm që ka Turqia si një vend mik dhe aleat i rëndësishëm për Shqipërinë dhe për gjithë rajonin e Ballkanit. Padiskutim Turqia është një fuqi rajonale me ndikim global, dhe marrëdhëniet me të është e rëndësishme për interesat tona kombëtare.

Por Perandoria Osmane është një tjetër realitet historik, dhe që nuk mund të ngatërrohet me shtetin modern turk.

Ky pushtim pesëshekullor nuk është as pengesë për marrëdhëniet e sotme, as arsye për konflikt. Ai është një fakt historik, që kërkon kujtesë, jo harresë; ndarje të qartë, jo relativizim.

Rreziku lind kur historianë të papërgjegjshëm përpiqen të ndërhyjnë në memorien kombëtare duke e zbutur, retushuar apo shtrembëruar të kaluarën në emër të “vëllazërisë historike”, që nuk ka ekzistuar kurrë gjatë pushtimit osman.

Nëse lejojmë që historia të përdoret për të justifikuar diplomacinë e ditës, atëherë po rrezikojmë vetë themelet e vetëdijes sonë kombëtare. Kjo është përgjegjësi e çdo shqiptari, por mbi të gjitha e historianëve.



Nga Dr. J. Scott Younger-IFIMES*

Presidenti Trump është tani në muajin e gjashtë të mandatit të tij aktual presidencial. Me marrjen e detyrës më 29 janar 2025, ai i ka dhënë medias shumë artikuj. Ai u mburr se kur të ishte President, do t'i jepte fund dy luftërave të vazhdueshme, Ukrainës dhe Izraelit, secila brenda një dite dhe nuk do të përfshihej në luftëra të tjera, të cilat premtime janë thyer. Ai ishte i bindur se “miqësia” e tij ishte mjaft e fortë sa të ishte në gjendje t'i bënte udhëheqësit e dy konflikteve, Putinin dhe Netanyahu, të ndalonin atë që po bënin.

Në kohën e shkurtër që ai ka qenë president, ata që duhet të marrin vendime të rëndësishme kanë pasur nevojë të mësojnë se si ta trajtojnë më mirë këtë njeri të paparashikueshëm dhe narcisist, duke i kushtuar shumë kohë përpjekjes. Ekipi i kabinetit të tij duhet të jetë besnik, më i rëndësishëm sesa të qenit kompetent. Në fakt, ekipi është si një njëmbëdhjetëshe e dytë, duke interpretuar shenjat që vijnë nga qarqet politike. A do të zgjasë ky ekip edhe tre vjet e gjysmë të tjera?

Ndërkohë, në tre muajt e fundit, izraelitët kanë shtrënguar kontrollin e tyre mbi Gazën, duke shpërfillur OKB-në dhe agjencitë

Lindja e Mesme – ku dhe kur do të jetë më pas?

Instituti Ndërkombëtar për Studime të Lindjes së Mesme dhe Ballkanit (IFIMES), me seli në Lubjanë, Slloveni, është i njohur për analizat e tij të thella të çështjeve globale, me një theks të veçantë në Lindjen e Mesme, Ballkan dhe rajone të tjera kyçe në të gjithë botën. Ndër kontribuesit e tij të shquar është Dr. J. Scott Younger, President Komisioner në Glendale Partners dhe anëtar i Bordit Këshillimor të IFIMES. Në artikullin e tij të titulluar “Lindja e Mesme – ku dhe kur do të jetë më pas?”, Dr. Younger analizon ndikimin e administratës Trump në zhvillimet e fundit në Gaza dhe Ukrainë.



e tjera të ndihmës dhe në këtë mënyrë ndihmën shumë të nevojshme për palestinezët e kapur në Gaza. Tani e gjithë kjo menaxhohet prej tyre. Ata në fakt i kanë lënë njerëzit të uritur, duke ngritur një ankesë universale duke folur me të drejtë për gjenocidin. Ata, së bashku me amerikanët, kanë krijuar një organ të ri që do të menaxhonte të gjithë ndihmën ushqimore që nga ajo kohë e tutje, pavarësisht se u këshillua fuqimisht se

sistemi që po shqyrtonin nuk do të funksiononte, por izraelitët ishin të vendosur të vazhdonin përpara. Kështu, në muajin e kaluar, kemi parë shumë qartë furnizime të pamjaftueshme dhe 400 vdekje nga IDF-të që synojnë dhe qëllojnë njerëz të uritur që vijnë përpara për furnizime. IDF-të thonë se ishin të shqetësuar se “turmat” e njerëzve që vijnë drejt tyre, sipas udhëzimeve të tyre, do t'u bëjnë dëm. Të paarmatosur!! Nuk e di se kë

po përpiqen të bindin. Ky është sistemi plotësisht i pakënaqshëm që ekziston aktualisht.

Tani që ka mbaruar, Izraeli filloi një luftë me Iranin, “armikun” e tyre, e cila zgjati 12 ditë. Ndërsa kryeministri Netanyahu flet me Trump çdo ditë, siç e pranon vetë, lufta duhet të ketë pasur miratimin e SHBA-së. Meqenëse Irani nuk ka një forcë ajrore për të cilën të flasë, Izraeli mund të bombardojë lirisht asetet bërthamore të Iranit, ndërsa Irani do të jetë në gjendje të kundërsulmojë vetëm me dronë dhe raketa, shumica e të cilave do të kapen nga “kupola e hekurt” e Izraelit.

Duhet të ketë një zgjidhje me dy shtete

Trump tregoi se do t'i lejonte Iranit deri në dy javë për t'u ulur në tryezën e negociatave, por më pas do ta bombardonte edhe Iranin. Në fakt, atij iu deshën vetëm 2-3 ditë për të bërë rregullimet për aeroplanët specialë që mund të hidhnin bomba që do të depërtonin në thellësitë e nevojshme për të shkatërruar objektet bërthamore të Iranit në Fordo, vendi ku po ndodhte pasurimi bërthamor në një nivel të kërkuar për bomba. Suksesi i plotë i Trumpit u arrit në fund të misionit. Megjithatë, provat do ta kundërshtojnë këtë, megjithëse kanë ndodhur disa dëme.

Netanyahu aktualisht po bën vizitën e tij të tretë në Shtëpinë e Bardhë. Trump ka deklaruar dëshirën e tij për t'i dhënë fund luftës në Gaza. Aktualisht po zhvillohen takime me përfaqësues të Izraelit, palestinezëve/Hamasit, katarit, egjiptianëve dhe SHBA-së për të diskutuar planin dy-mujor të armëpushimit të Trump si një hap i parë drejt një zgjidhjeje të përhershme. Kjo periudhë do të përdoret për të përfunduar

shkëmbimin e pengjeve. Por çfarë ndodh në planin afatgjatë?

Hamasi dëshiron një armëpushim të përhershëm, ndërsa Netanyahu dëshiron të rifillojë armiqësitë pas dy muajsh për të shkatërruar plotësisht Hamasin. E djathta ekstreme e qeverisë izraelite dëshiron që palestinezët të kufizohen në një hapësirë të caktuar rreth Rafah, ndërsa ata marrin pjesën tjetër të Gazës. Ka pasur sinjale alarmi të zëshme nga OKB-ja dhe BE-ja dhe vende të tjera në botë se kjo shkel ligjin ndërkombëtar. Shumë varet tani nga Donald Trump dhe nëse bindja e Bibi Netanyahu, i cili dje kuptoi se mënyra për ta bindur Trumpin ishte ta lavdëronte atë edhe një herë. Kjo u bë gjatë darkës në Shtëpinë e Bardhë duke i dorëzuar një letër në të cilën ai rekomandonte Trumpin për çmimin Nobel për Paqen!! Është bërë e ditur se ai dëshiron këtë nder të lartë. Nga një kriminel i shpallur të një tjetër. Kjo nuk duhet të ndodhë – të paktën derisa ai t'i ketë provuar botës se e ka merituar atë, dhe kjo do të duhet pak kohë. Ne presim dhe do të shohim.

Duhet të ketë një zgjidhje me dy shtete, drejtësi për palestinezët, një periudhë 10-vjeçare dorëzimi me një grup të vogël personash të shquar dhe empatikë për të ndihmuar një shtet embrionik me kufij të përcaktuar dhe jo të varur nga Izraeli. SHBA-të duhet të luajnë një rol të rëndësishëm, ashtu si BE-ja dhe fqinjët e tjerë arabë. Trump madje mund të sjellë idenë e tij të Rivierës së Lindjes së Mesme si pjesë të zgjidhjes. Në këtë mënyrë, ai mund të tregonte vërtetë qëllimet e tij për paqe.

Hapat që SHBA-të duhet të ndërmarrin në të ardhmen
Ndërkohë, ndërsa SHBA-të ishin

të shpërqendruara nga situata me Iranin, Putini filloi ta përshpejtonte luftën e tij në Ukrainë. Ai pak a shumë e kishte refuzuar sugjerimin e Trumpit për një armëpushim dy-mujor dhe kohët e fundit ka shtuar bombardimet ajrore të Ukrainës. Putini gjithashtu ka dërguar 30,000 trupa të tjera nga Koreja e Veriut dhe po ecën përpara me forcat e tij tokësore.

Trump i bëri një telefonatë Putinin kohët e fundit, e cila ishte e pakënaqshme dhe e cila të paktën ia sqaroi në mendje qëndrimin që SHBA-të duhet të mbajnë në të ardhmen. Takimi i fundit i NATO-s, në të cilin ai mori pjesë, duhet t'i ketë dhënë njëfarë ngushëllimi, evropianët që nënshkruan një angazhim financiar për vend prej 5% të PBB-së brenda dhjetë viteve. Ai është riangazhuar me Ukrainën duke dërguar ndihmë me armë, të cilën e kishte ndërprerë kohët e fundit me mirëkuptimin se “miku” i tij Putin do të binte dakord me propozimin e tij për armëpushim. Ky është një lehtësim për evropianët, të cilët nuk janë plotësisht të gatshëm të kundërshtojnë përparimin rus brenda Ukrainës.

Kthehemi te Gaza, e cila mbetet një situatë shumë e ndërlikuar për t'u zgjidhur. Ka ndërlikime, veçanërisht nëse e djathta ekstreme lejohet të ushtrojë pushtetin e saj të dukshëm. Së pari, ajo që do të bëjë Trump do të japë një tregues të asaj që mund të pasojë. Nuk mendoj se do të na duhet të presim gjatë.

**Kancelar Ndërkombëtar i Universitetit President në Indonezi, Bashkëpunëtor Nderi i Lartë Kërkimor i Universitetit të Glasgout dhe anëtar i Bordit Këshillimor të IFIMES*
***IFIMES**

EKSKLUZIVE

Ambasadori palestinez në Shqipëri, Z. Sami Mhanna bën thirrje për Drejtësi dhe Paqe në Gaza: Ne meritojmë të jetojmë në dinjitet si kombet e tjera!

Intervistoi: MARJANA DODA

"Intervistë ekskluzive për Argumentum.al me SHTZ. Sami Mhanna, Ambasador i Shtetit të Palestinës në Shqipëri."

Ndërsa konflikti Izrael-Gaza hyn në muajin e tij të 16-të, i shënuar nga humbje të mëdha njerëzore, Argumentum.al zhvilloi një intervistë ekskluzive me Shkëlqesinë e Tij Sami Mhanna, Ambasadorin e sapoemëruar të Shtetit të Palestinës në Republikën e Shqipërisë.

"Është thellësisht shqetësuese që, edhe në shekullin e 21-të, Palestina mbetet nën pushtim. Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë Kombet e Bashkuara, ka qenë dëshmitar i akteve të tmerrshme të kryera në Gaza. Megjithatë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim efektiv ose serioz për ta mbajtur Izraelin përgjegjës ose për të ndaluar këtë gjenocid të vazhdueshëm. Tragjikisht, spastrimi etnik i popullit palestinez vazhdon i pandërprerë para syve të botës", deklaroi Ambasadori Mhanna.

I emëruar së fundmi si ambasador në Tiranë, Ambasadori shprehu mirënjohje për mbështetjen e gjatë të Shqipërisë për Palestinën, që daton që nga njohja e shtetësisë palestineze në vitin 1988. Ai vlerësoi Presidentin Bajram Begaj për angazhimin e tij për paqen dhe zgjidhjen me dy shtete, si dhe për nxitjen e një mjedisi mikpritës për bashkëpunim më të thellë diplomatik.



Ambasadori theksoi prioritetet e tij diplomatike, të cilat përfshijnë forcimin e lidhjeve politike dhe kulturore, rritjen e angazhimit arsimor dhe të të rinjve, si dhe avancimin e diplomacisë publike. Ai nënvizoi rolin e tij në rritjen e ndërgjegjësimit rreth luftës palestineze, veçanërisht përballë asaj që ai e përshkroi si një gjenocid të vazhdueshëm në Gaza.

Ndërsa dënoi viktimat civile nga të gjitha anët, Ambasadori theksoi se diplomacia – jo dhuna – është e vetmja rrugë përpara. Ai u bëri thirrje fuqive globale, veçanërisht Shteteve të Bashkuara, të luajnë

një rol më të balancuar dhe më të përgjegjshëm në avancimin e paqes, duke shprehur skepticizëm ndaj pretendimeve të fundit të armëpushimit të Presidentit të SHBA-së Donald Trump.

Drejt një Zgjidhjeje Politike

Ambasadori përsëriti kërkesat kryesore të Palestinës: një armëpushim të menjëhershëm, tërheqjen e Izraelit nga Gaza, lirimin e të burgosurve dhe fillimin e një procesi të vërtetë politik të bazuar në të drejtën ndërkombëtare. Ai bëri thirrje për krijimin e një shteti të pavarur palestinez bazuar në ku-

fijtë e vitit 1967, me kryeqytet Jerusalemin Lindor.

“Populli ynë meriton të jetojë në paqe dhe dinjitet”, tha ai. “Ka ardhur koha që bota të veprojë – jo vetëm të flasë – për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme.”

“Diplomacia, jo lufta, është rruga drejt paqes. Por paqja duhet të ndërtohet mbi të vërtetën, llogaridhënien dhe të drejtën e njerëzve për të jetuar në liri”, thekson ai në intervistën e mëposhtme.

–Znj. Marjana DODA: Z. Ambasador, pak kohë më parë i keni dorëzuar kredencialet Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Si e vlerësoni këtë moment dhe si i konsideroni marrëdhëniet midis Palestinës dhe Shqipërisë?

–SHTZ. Sami MHANNA: Është një nder dhe privilegj i madh të përfaqësoj vendin tim si Ambasador i Palestinës në Republikën e Shqipërisë, të dyja vendet kanë një marrëdhënie të fortë që nga njohja e shtetit të Palestinës në vitin 1988. Shqipëria ishte ndër vendet që besonin në të drejtën tonë absolute për të pasur sovranitetin tonë dhe për të krijuar shtetin tonë bazuar në të drejtën ndërkombëtare. Mbështetja e madhe që marr nga populli më lë pa fjalë, ku shkoj, shoh se njerëzit këtu e dinë shumë për kauzën tonë dhe e dinë sa shumë vuajmë nga pushtimi 77-vjeçar.

Për aq sa mbaj mend, kam pasur shumë momente të veçanta në jetën time. Dita kur u diplomova, dita kur u emërova Ambasador dhe dita kur i dorëzoja kredencialet Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj. Ishte emërimi im i parë si Ambasador, jo vetëm, por edhe më i riu në qeverinë time aktuale. Ishte një moment i veçantë për mua takimi



me presidentin z. Begaj. Ai është një njeri modest dhe dinjitoz, i kuptueshëm dhe shumë i mençur. Ai ka njohuri të gjera dhe është informues për situatën në Lindjen e Mesme, veçanërisht për konfliktin në Palestinë. Ai u përqendrua në vendosjen e paqes dhe zgjidhjen me dy shtete bazuar në të drejtën ndërkombëtare. Ai ka qenë i sjellshëm duke më dhënë mundësinë të punoj më thellë me institucionet në Shqipëri për të përmirësuar marrëdhëniet tona në fusha të ndryshme. U ndjeva shumë i mirëpritur në Shqipëri dhe kjo më ka dhënë një ndjesi positive.

–Si Ambasador i Palestinës në Shqipëri, cilat janë prioritetet tuaja kryesore gjatë mandatit tuaj? Në cilat fusha specifike të bashkëpunimit synoni të përqendrohemi dhe si planifikoni të forconi lidhjet politike, kulturore dhe diplomatike midis Palestinës dhe Shqipërisë?

Fokusi ynë kryesor si Qeveri e Palestinës është të rrisim ndërgjegjësimin rreth luftës sonë të vazhdueshme.

Për gati 16 muaj, populli ynë është përballur me një genocid. Mijëra jetë të pafajshme janë humbur, shumë prej tyre gra dhe fëmijë.

Si Ambasador, detyra ime është të

flas të vërtetën tragjike dhe të ndaj luftën e popullit tim. Ne e bëjmë këtë përmes leksioneve publike, prezantimeve për studentët, ngjarjeve kulturore dhe dialogut. Fokusi im kryesor është në diplomacinë politike, diplomacinë kulturore dhe publike dhe forcimin e marrëdhënieve dypalëshe. Ne duhet t'i tregojmë botës se jeta e popullit tonë ka rëndësi. Ne jemi një komb me një trashëgimi të thellë dhe jo vetëm kauzë, dhe përmes kulturës, arsimit dhe dialogut, synojmë ta bëjmë këtë mesazh të qartë dhe bindës.

Marrëdhëniet diplomatike midis Shtetit të Palestinës dhe Republikës së Shqipërisë janë shumë të mira. Ne vazhdojmë t'i forcojmë ato përmes respektit të ndërsjellë, konsultimeve politike midis ministrive të jashtme, nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe inkurajimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis qyteteve, universiteteve dhe dhomave të tregtisë, duke u angazhuar në diplomacinë publike.

– Konflikti izraelito-palestinez ka hyrë në një fazë kritike pas sulmit të 7 tetorit dhe reagimit të ashpër të Izraelit. Gaza po përballet me një krizë humanitare të paprecedentë, sipas shumë organizatave ndërkombëtare. Cila është situata aktuale në terren për civilët palestinezë? Situata aktuale në Palestinë është përtej çdo përfytyrimi.

Ne vazhdojmë të jemi nën një pushtim brutal prej 77 vjetësh, dhe populli ynë po përjeton format më të këqija të vuajtjes së imagjinueshme. Në Gaza, mbi 2.2 milionë civilë rrezikojnë të shpërngulen me forcë dhe jetojnë nën një kërcënim të vazhdueshëm. Ne e vlerësojmë shumë hapin e rëndësishëm të marrë nga Egjipti dhe Jordania në refuzimin e shpërnguljes së detyruar të banorëve të Gazës; një veprim i tillë është i papranueshëm dhe përbën një shkelje të qartë të ligjit ndërkombëtar dhe të të drejtave humanitare.

Edhe në Bregun Perëndimor, populli ynë përballet me sulme

të vazhdueshme nga kolonët, arrestime të fëmijëve dhe kufizime në të drejtat themelore, përfshirë edhe lirinë e faljes.

Izraeli vazhdon të konfiskojë toka, të zgjerojë vendbanimet e tij ilegale dhe të kryejë shkelje ndaj civilëve palestinezë. E gjithë situata në Bregun Perëndimor është e paqëndrueshme dhe tepër shqetësuese.

Që nga 7 tetori, më shumë se 58,000 civilë palestinezë janë vrarë, mbi 50,000 fëmijë janë bërë jetimë dhe më shumë se 120,000 civilë kanë pësuar amputime për shkak të sulmeve të pandalshme.

Forcat ushtarake izraelite kanë përdorur armë të ndaluara ndërkombëtarisht, përfshirë fosforin e bardhë, një substancë që djeg në mënyrë të pandërgjegjshme dhe lë plagë shkatërruese.

Izraeli ka goditur dhe shkatërruar me qëllim shkolla, spitale, ndërtesa banimi dhe vende të adhurimit, si kisha ashtu edhe xhamitë. Për më keq, ata kanë vendosur një bllokadë totale, duke penguar hyrjen e pajisjeve mjekësore jetike, ushqimit, ujit dhe strehimit. Këto nuk janë incidente të izoluar; ato janë shkelje sistematike të ligjit ndërkombëtar dhe parimeve themelore humanitare.

Është shumë shqetësuese që në shekullin e 21-të, Palestina të mbetet e pushtuar.

Bota, përfshirë Kombet e Bashkuara, ka parë mizoritë e kryera në Gaza. Megjithatë, nuk janë ndërmarrë masa reale apo serioze për të mbajtur Izraelin përgjegjës apo për të ndaluar këtë gjenocid. Tragjikisht, pastrimi etnik i popullit palestinez vazhdon para syve të komunitetit ndërkombëtar.

– Zoti Ambasador, me konf-



liktin në vazhdimësi në Gaza dhe një numër të jashtëzakonshëm viktimash që afrohet me 60,000, shumica gra, fëmijë dhe të moshuar, si e vlerësoni rolin e Kombeve të Bashkuara në këtë krizë? A mendoni se OKB-ja ka dështuar në misionin e saj kryesor për të ruajtur paqen dhe për të mbrojtur civilët?

Unë besoj se ngjarjet e 7 tetorit ishin një reagim nga Hamas-i ndaj presionit të vazhdueshëm dhe në rritje që Izraeli i ka ushtruar ndaj popullit palestinez, si në Bregun Perëndimor ashtu edhe në Gaza. Arrestimet, vrasjet dhe ndëshkimet kolektive të civilëve kanë çuar situatën në një pikë shpërthyes, duke bërë që Hamas të ndërmarrë veprimet që ndërmori. Megjithatë, dua të jem i qartë: Nuk mbështes vrasjen e civilëve, as të izraelitëve, as të palestinezëve, as të grave apo fëmijëve. Veprime të tilla janë çnjerëzore dhe të papranueshme. Dhuna ndaj njerëzve të pafajshëm, pavarësisht se kush e kryen, duhet të dënohet gjithmonë.

Unë mendoj se Hamas-i ka vepruar pa mendje. Pasojat kanë qenë shkatërruese. Gaza është shkatërruar pothuajse plotësisht — tani është e paidentifikueshme, e pabanueshme dhe toksike. Ky qytet, dikur ndër më të bukurit në Palestinë, tani qëndron në rrënoja. Personalisht besoj në diplomaci dhe dialog politik.

Këto janë mjetet më të fuqishme që kemi për të ndërtuar paqen, për të gjetur zgjidhje dhe për të përfunduar pushtimin. Kjo është arsyeja pse Izraeli vazhdimisht shmang angazhimin politik të rëndësishëm dhe në vend të tij vazhdon të mbështetet në forcën ushtarake, e cila mbështetet pa kushte nga Shtetet e Bashkuara,

kundër një popullsie pothuajse të pambrojtur.

Dinamika e botës po ndryshon. Duhet të fillojmë të mendojmë seriozisht për të ardhmen e fëmijëve tanë: t'u sigurojmë atyre të drejtën për të jetuar në paqe, për të ëndërruar, për të rritur dhe për t'u zhvilluar.

Është koha të përfundojë pushtimi dhe të ndërtohen themelet për shtetin tonë të pavarur palestinez.

– **Presidenti Trump kohët e fundit ka premtuar një armëpushim në Gaza dhe ka deklaruar se paqja në Lindjen e Mesme mund të arrihet brenda javësh. Si e vlerësoni këto deklarata në kuadrin më të gjerë gjeopolitik? Duke pasur parasysh rrjetin kompleks të interesave rajonale dhe ndërkombëtare, nga ndikimi i SHBA-ve deri te aleancat në ndryshim në Lindjen e Mesme, a**

Ne kemi shpresuar sinqerisht që Shtetet e Bashkuara do të merrnin një rol konstruktiv dhe përgjegjës në promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, veçanërisht në avancimin e një zgjidhjeje për popullin palestinez. Ne prisnim që administrata Trump të përdorte ndikimin e saj për të ushtruar presion real ndaj qeverisë së Kryeministrit Netanyahu për të ndalur politikat diskriminuese dhe shkeljet e vazhdueshme të ligjit ndërkombëtar dhe të drejtave themelore të njeriut.

i shihni këto iniciativa si të besueshme dhe potencialisht efektive, apo thjesht retorikë politike për përfitime afatshkurtra?

Që në fillim, objektivat politike të administratës së Presidentit Trump reflektonin një mbështetje të palëkundur për Qeverinë e Izraelit.

Administrata ka ofruar vazhdimisht mbështetje të plotë Izraelit, politikisht dhe ushtarakisht, duke përfshirë furnizimin me armë dhe pajisje ushtarake të avancuara. Kjo mbështetje në praktikë i ka mundësuar Izraelit të vazhdojë operacionet kundër civilëve palestinezë si në Gaza ashtu edhe në Bregun Perëndimor.

Ne kemi shpresuar sinqerisht që Shtetet e Bashkuara do të merrnin një rol konstruktiv dhe përgjegjës në promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, veçanërisht në avancimin e një zgjidhjeje për popullin palestinez. Ne prisnim që administrata Trump të përdorte ndikimin e saj për të ushtruar presion real ndaj qeverisë së Kryeministrit Netanyahu për të ndalur politikat diskriminuese dhe shkeljet e vazhdueshme të ligjit ndërkombëtar dhe të drejtave themelore të njeriut.

Në vend të kësaj, ajo që po shohim është një standard i dyfishtë i qartë dhe një shmangie e hapur e të drejtave të palestinezëve.

Ekzistojnë raportime se Presidenti Trump po konsideron madje të japë imunitet ose falje për Kryeministrin Netanyahu për veprimet e tij, duke e mbrojtur atë nga përgjegjësia ligjore dhe ndjekja penale. Një armëpushim në këtë moment është thelbësor, pasi gjenocidi kundër popullit tonë në Gaza përkeqësohet çdo minutë, numri i viktimave civile vazhdon të rritet, dhe situata humanitare

është katastrofike.

– Ekselencë, cilat janë kërkesat kryesore të Palestinës në këtë konflikt? A duhet fokusi të jetë në sigurimin e njohjes së një shteti të pavarur bazuar në kufijtë e vitit 1967 me Jerusalemin Lindor si kryeqytet, apo ka prioritetet të tjera që duhet të trajtohen për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme? Sipas jush, si mund të zgjidhet ky konflikt dhe cilat duhet të jenë prioritetet e menjëhershme përpara?

Prioriteti i Autoritetit Palestinez nën drejtimin e Presidentit Mahmoud Abbas është të përfundojë lufta kundër popullit tonë dhe të hyjë në një fazë të re, që siguron tërheqjen e Izraelit nga Rripi i Gazës dhe nisjen e një procesi gjithëpërfshirës politik të bazuar në legjitimitetin ndërkombëtar dhe zgjidhjen me dy shtete.

Fokusi ynë i menjëhershëm mbetet ndalimi i kësaj agresioni brutale kundër popullit palestinez, lirimi i pengjeve dhe i të burgosurve tanë, dhe më pas nisja e një horizonte politike. Kjo fazë e ardhshme duhet të përfshijë tërheqjen e plotë të Izraelit nga Gaza dhe ringjalljen e një procesi serioz dhe të besueshëm politik — i cili të bazohet në ligjin ndërkombëtar dhe të çojë në realizimin e zgjidhjes me dy shtete, bazuar në kufijtë e vitit 1967, me Jerusalemin Lindor si kryeqytet të Shtetit të Palestinës.

Nga këndvështrimi im, zgjidhja më efektive dhe e drejtë qëndron në rrugën politike përmes diplomacisë dhe negociatave të singerta, me qëllim rikthimin e të drejtave legjitime të popullit palestinez në përputhje me ligjet ndërkombëtare, rezolutat e OKB-së dhe parimet universalisht të

pranuara.

Dhuna, në çdo formë, nuk mund të jetë rruga për të arritur një paqe gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Është e domosdoshme që qeveria izraelite të braktisë politikatat aktuale të pastrimit etnik dhe zgjerimit të vendbanimeve, dhe në vend të tyre të tregojë vullnetin politik dhe guximin e nevojshëm për të ndjekur zgjidhje të drejta, të qëndrueshme dhe të pranueshme për të gjitha palët.

– Shpesh ka paqartësi rreth strukturës politike të Palestinës. Si qeveriset Gaza dhe cili është pozicioni zyrtar i Autoritetit Palestinez ndaj aktorëve të përfshirë në konflikt?

Autoriteti Palestinez është autoriteti legjitim që duhet të ushtrojë qeverisjen mbi Rripin e Gazës, sapo lufta të përfundojë.

Është thelbësore të theksohet se asnjë entitet tjetër nuk do të jetë i pranueshëm si

Prioriteti i Autoritetit Palestinez nën drejtimin e Presidentit Mahmoud Abbas është të përfundojë lufta kundër popullit tonë dhe të hyjë në një fazë të re, që siguron tërheqjen e Izraelit nga Rripi i Gazës dhe nisjen e një procesi gjithëpërfshirës politik të bazuar në legjitimitetin ndërkombëtar dhe zgjidhjen me dy shtete. Fokusi ynë i menjëhershëm mbetet ndalimi i kësaj agresioni brutale kundër popullit palestinez, lirimi i pengjeve dhe i të burgosurve tanë, dhe më pas nisja e një horizonte politike.

autoritet qeverisës në Gaza përveç udhëheqjes legjitime palestineze dhe Qeverisë së Shtetit të Palestinës.

Çdo propozim apo përpjekje për të ndarë Gazën nga Bregu Perëndimor i pushtuar duhet të refuzohet prerë dhe kategorikisht. Gaza dhe Bregu Perëndimor janë pjesë integrale të shtetit të ardhshëm të Palestinës, dhe çdo plan që synon të dëmtojë këtë unitet minon shanset për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.

– Çfarë pritshmëri keni nga Qeveria e Shqipërisë, veçanërisht në dritën e mbështetjes së saj publike për zgjidhjen me dy shtete si bazë për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palastinez?

Ne besojmë se Qeveria e Shqipërisë dhe populli i saj mbajnë vlera të forta në drejtësi, liri dhe respekt për të drejtat e njeriut. Shqipëria, si një vend me një histori rezistence, e kupton mirë se çfarë do të thotë të qëndrosh në anën e parimeve njerëzore.

Megjithatë, ne besojmë gjithashtu se është e nevojshme të merret një qëndrim i qartë dhe i pakundërshtueshëm kundër pushtimit izraelit dhe zgjerimit të vazhdueshëm të vendbanimeve ilegale — jo vetëm si një akt solidariteti me popullin palestinez, por edhe si një qëndrim për ligjin ndërkombëtar dhe drejtësinë universale.

Zbatimi i rezolutave të Kombeve të Bashkuara lidhur me çështjen palestineze duhet të jetë prioritet, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe parimet e përbashkëta të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut. Kjo do të ndihmojë në krijimin e kushteve për një rrugë më të shpejtë dhe më të besueshme drejt paqes, e cila do të bazohet në

zgjidhjen me dy shtete.

Ne besojmë fuqishëm se paqja e vërtetë dhe e qëndrueshme mund të ndërtohet vetëm mbi bazën e drejtësisë dhe parimeve që Shqipëria prej kohësh përfaqëson, dhe të cilat vazhdojnë të udhëheqin aspiratat e të gjithë njerëzve që kërkojnë liri dhe dinjitet.

– Qytetarët shqiptarë kanë organizuar protesta në Tiranë duke dënuar dhunën në Gaza dhe shprehur solidaritet me popullin palestinez. Demonstrata të ngjashme kanë ndodhur në mbarë botën, ku njerëzit kërkojnë ndalimin e menjëhershëm të sulmeve dhe bëjnë thirrje për ndërhyrje të komunitetit ndërkombëtar. Si e vlerësoni reagimin publik global, përfshirë atë të Shqipërisë, dhe a mendojnë se lëvizjet e solidaritetit nga baza mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përfundimin e luftës në Gaza?

Po, kam qenë dëshmitar i shumë demonstratave paqësore këtu në Shqipëri dhe në disa vende të Evropës Perëndimore, të cilat shprehin solidaritet me çështjen palestineze.

Kjo është një qëndrim pozitiv dhe thellësisht human, një shprehje e empatisë dhe përgjegjësisë morale përballë dhunës së përditshme dhe kushteve pothuajse gjenocidale që përjeton populli palestinez.

Besoj fuqishëm se aktet paqësore të solidaritetit mund të ndikojnë në opinionin publik dhe më pas të ushtrojnë presion mbi qeveritë që të rishikojnë pozicionet e tyre politike.

Këto demonstrata mund të ndihmojnë në mbajtjen përgjegjëse të pushtetit pushtues dhe në rritjen e njohjes së vuajtjeve të

Ne, si popull palestinez, jemi një komb që beson në paqe. Ne kërkojmë të jetojmë në paqe dhe dinjitet, dhe të kemi lirinë tonë. Kemi humbur shumë jetë të pafajshme. Ajo që po ndodh është një katastrofë humanitare. Izraeli nuk ka të drejtë të vazhdojë këtë brutalitet. Politikat e tij janë bërë të qarta, dhe e vërteta nuk mund të injorohet më. Kërkojmë mbrojtje ndërkombëtare për fëmijët tanë dhe llogaridhënie për krimet e kryera kundër popullit tonë.

popullit tonë.

Gjithashtu, ato luajnë një rol jetik në rritjen e ndërgjegjësimit publik, duke ndihmuar në përhapjen e një imazhi të saktë dhe human për atë që po ndodh në Palestinë për botën më të gjerë.

Veçanërisht në Shqipëri, kam parë këtë frymë solidariteti nga afër. Shumë shqiptarë janë mirëinformuar për padrejtësitë që po ndodhin në Gaza dhe Bregun Perëndimor dhe nuk janë të heshitur. Që nga ardhja ime, kam vizituar disa qytete, përfshirë Vlorën dhe Durrësin, dhe kam takuar shumë individë që kanë shprehur mbështetjen e tyre të palëkundur për çështjen palestineze.

Megjithatë, demonstratat paqësore vetëm nuk janë të mjaftueshme për të ndalur luftën apo për të përfunduar pushtimin.

Ndërsa këto veprime janë të fuqishme në nivel shoqëror, ndryshimi i fuqishëm mbetet në duart e shteteve të fuqishme. Së pari dhe mbi të gjitha, Shtetet e Bashkuara.

SHBA-ja ka ndikim të madh dhe kapacitet për të ushtruar presion mbi Izraelin që të ndalojë agressionin dhe të angazhohet në një proces serioz drejt një zgjidhjeje politike të drejtë. Pa këtë vullnet politik ndërkombëtar, vuajtjet vazhdojnë dhe zërat e miliona njerëzve mbeten të padëgjuar.

– Së fundmi, cili është mesazhi juaj për komunitetin ndërkombëtar dhe institucionet globale si OKB dhe BE? Çfarë veprimesh urgjente janë të nevojshme për të adresuar katastrofën humanitare dhe për të avancuar drejt një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme?

Ne, si popull palestinez, jemi një komb që beson në paqe.

Ne kërkojmë të jetojmë në paqe dhe dinjitet, dhe të kemi lirinë tonë. Kemi humbur shumë jetë të pafajshme. Ajo që po ndodh është një katastrofë humanitare.

Izraeli nuk ka të drejtë të vazhdojë këtë brutalitet. Politikat e tij janë bërë të qarta, dhe e vërteta nuk mund të injorohet më.

Kërkojmë mbrojtje ndërkombëtare për fëmijët tanë dhe llogaridhënie për krimet e kryera kundër popullit tonë.

I bëjmë thirrje komunitetit ndërkombëtar dhe organizatave globale që të ushtrojnë presion të vërtetë mbi Izraelin për të ndaluar urinë dhe për të përfunduar gjenocidin në vazhdim në Gaza. Mjaft më!

Ne nuk po kërkojmë mrekulli, por po kërkojmë të drejtat tona legjitime — përfundimin e pushtimit dhe themelimin e shtetit tonë të pavarur mbi kufijtë e vitit 1967, me Jerusalemin Lindor si kryeqytet.

Ne meritojmë të jetojmë në dinjitet si kombet e tjera.

Ekuacion gjeopolitik me disa të panjohura. Peshku në det, tigani në zjarr! Kthesa e madhe amerikane! Trojka europiane franko-gjermano-britanike

REAL POLITIK NR. 111 | 01 – 21 KORRIK 2025 | EKSLUZIVE PËR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur, Mjeshtër i Madh në Diplomaci

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Ekuacion gjeopolitik me disa të panjohura: Për këtë ekuacion u diskutua gjatë vizitës në Uashington të Kryeministrit izraelit Netanyahu me Presidentin Trump më 7/8 Korrik. Me premtime për një paqe të shpejtë në Gaza dhe në vendet e rajonit, për një Lindje të Mesme të Re, sipas Presidentit Trump. Ndonëse siç i thonë fjalës, kjo është ” më e lehtë në të thënë se në të bënë”, ca më pak brenda natës apo dhe vitit. Kjo mbasi në këtë rebus gjeopolitik janë të përfshirë me probleme, grindje dhe mosmarrëveshje mes tyre të paktën 10 aktorë/faktorë madhorë gjeopolitikë -SHBA-të, Rusia, Turqia, Izraeli, Arabia Saudite, Irani, Egjipti, Siria, Libani, Jordania, Palestina, etj. Kështu kemi konfliktin ende të pazgjidhur midis Izraelit dhe Iranit, me Huthët dhe Hezbollahun; tani së fundi ka dalë në pah dhe konflikti midis Tel Avivit dhe Damaskut mbas përlëshjeve në jug të Sirisë kundër pakicave fetare duzë, që vijon edhe pse më 18 korrik atje u arrit armëpushimi; Arabia Saudite do marrëveshje me Izraelin, por me kusht të tërheqjes nga dhuna e tanishme në Gaza e sidomos njohjes së Palestinës nëpërmjet zgjidhjes



”me dy shtete”: Libani dhe Siria kanë dhe ato kushtet e tyre për t’u bërë pjesë e marrëveshjeve ”Abraham”. Pa harruar çështjen kyçe palestineze, dhe zgjidhjen ”me dy shtete”, të cilën ekstremi i djathtë dhe Kryeministri izraelit e kundërshtojnë. Mirëpo pa zgjidhur çështjen e banorëve të Gazës dhe të Palestinës në përgjithësi, do të jetë e pamundur të zgjidhet ky ekuacion me disa të panjohura dhe ca më pak të ketë paqe dhe stabilitet në Lindjen e Afërme dhe të Mesme.

2.

Peshku në det, tigani në zjarr: Ky aforizëm i shkon për shtat Samitit për Rindërtimin e Ukrainës, të mbajtur në Romë më 10 /11 Korrik me praninë e mbi 60 liderëve

nga gjithë bota. Ai konfirmoi se rindërtimi i saj do të kërkojë 14 vite dhe një fond kolosal prej 850 miliard Euro nga 500 miliard që ishte vlerësimi i mëparshëm. Problemi me këtë Samit, i katërti mbas atij të zhvilluar vitin e kaluar në Berlin është se nuk dihet se kur do të mbarojë kjo luftë. Dhe nëse do të ketë paqe, me çfarë kushtesh, apo të ndarjes së Ukrainës sipas modelit më të mirë të ndarjes, atij të Koresë së Jugut? Ndaj kishte të drejtë Kancelari gjerman Friedrich Merz kur më 18 korrik deklaroi se është ende herët të flitet për anëtarësimin e Kievit në BE përpara vitit 2034. Se duhet të përfundojë lufta, rindërtimi dhe pastaj i vjen radha BE-së. Ja, pse ky samit të kujton thënien “ peshku në det, tigani në zjarr”!

3.

Kthesa madhore amerikane: U njoftua gjatë takimit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Mark Rutte në Shtëpinë e Bardhë me Presidentin Trump me 14 Korrik. Aty Trump shpalli se SHBA-të do të dërgojnë në Ukrainë së shpejti sistemet raketore "Patriot" dhe armatime të tjera, të cilat do të financohen nga Gjermania dhe vende të tjera të BE-së. Kjo ishte një kthesë madhore e shumëpritur, që i shërben forcimit të pozitës ushtarake ukrainase. Gjithashtu Trump dha ultimatumin që brenda 50 ditëve Putini të ulet në bisedime për një armëpushim, ndryshe do të zbatojë tarifa 100 për qind ndaj mallrave ruse si dhe tarifa dytësore për vendet që importojnë mallra nga Moska. Problemi është se ky afat 50 ditësh është kohë e gjatë dhe le vend për hamendësime, dyshime dhe abuzime nga Rusia, e cila dhe pas ultimatumit i ka intensifikuar sulmet kundër Ukrainës. Ndërkohë, diplomacia ruse ka kohë të mendojë dhe zbatojë alternativa të shumta për të shmangur zbatimin e ultimatumit të lartpërmendur, siç ka bërë dhe më parë; në fakt më 18 korrik pati një bisedë telefonike Putin – Erdogan, ku u shpreh gatishmëria për raundin e tretë të negociatave. Ndërkohë deri atëherë nuk dihet dhe se çfarë qëndrimesh do të mbajë Presidenti Trump, i njohur për paparashikueshmërinë e tij.

4.

Trojka europiane franko-gjermano-britanike po forcohet çdo ditë këto muajt e fundit me shumë takime dhe marrëveshje. Kështu, më 10 korrik, Presidenti Macron bëri vizitën shtetërore në Londër, ku u prit me nderimet më



të larta. Me atë rast ai nënshkroi Marrëveshje me Kryeministrin Starmer, si vijim i Traktatit BE-Britani e Madhe; ajo garanton kryesisht bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe gatishmërinë për të mbrojtur aleatët e tjerë me ombrellën e tyre bërthamore. Po ashtu lufta kundër migrimit të paligjshëm dhe lëvizjes së lirë të rinisë dhe të studentëve. Ndërsa më 17 Korrik ishte në Londër Kancelari gjerman Merz, i cili nënshkroi me homologun britanik Starmer Paktin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit. Ai përfshin fushën e bashkëpunimit ekonomik, luftën kundër migrimit të paligjshëm, shkëmbimet studentore dhe në përgjithësi lëvizjen e lirë të shtetasve dhe bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, çka përbën dhe thelbin e tij. Këtu përfshihet dhe bashkëpunimi në fushën e industrisë ushtarake, prodhimi i përbashkët i avionave, tankeve, autobлиндave, predhave të artilerisë, etj. Në vijim, më 23 Korrik do të shkojë në Berlin Presidenti francez Macron, ku do të diskutohet mbi të njëjtat tema

dhe mbështetja për Ukrainën. Këto vizita dhe marrëveshje domethënëse vijnë pas Samitit historik të NATO-s në Hagë, ku u miratua kuota 5 për qind e GDP-së së vendeve anëtare për mbrojtjen; ndërkohë, pritjet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve të tjera të BE-së, me qëllim që ky 5 për qindësh i rëndësishëm të ketë sa më shumë efektivitet ekonomik dhe industria ushtarake në të dy vendet dhe në Europë të rivihet në punë shumë më shpejt se procedurat e zakonshme në kuadrin e riarmatimit të Europës. Këto dhe me qëllimin që kur të vijë puna për bisedimet e paqes midis Rusisë dhe Ukrainës, kjo e fundit të jetë në pozita sa më të forta. Të tria këto vende bashkë me Poloninë, Italinë dhe të tjera janë të vendosur për të shtuar ndihmat ushtarake dhe ekonomike ndaj Ukrainës. Me nismën e tyre, më 18 Korrik, pas "dorëzimit" të Sllovakisë, BE-ja miratoi dhe paketën e 18-të të sanksioneve kundër Rusisë. Kështu, forcimi i boshtit franko-gjerman të BE-së dhe afrimi i saj i vazhdueshëm me Britaninë e Madhe krijojnë një bërthamë të fuqishme politike, ekonomike dhe ushtarake, si thelbi i bashkimit të madh mbrojtës dhe "europianizimit" të NATO-s. Gjithsesi, për këtë të fundit kërkohet kohë, projekte dhe konkretizimi i planeve dhe marrëveshjeve që janë nënshkruar dhe gjatë kësaj periudhe.



Hapet grup-kapitulli i fundit BE-Shqipëri



Shqipëria po shkon drejt përmbylljes së hapjes së të gjithë kapitujve të negociatave me BE-në.

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të Vendeve Anëtare të Bashkimit European autorizoi sot Presidencën Daneze të ftojë Shqipërinë për të paraqitur Pozicionin e saj Negociues për negociatat lidhur me kapitujt që përbëjnë Grup-kapitullin 5: “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”.

Ky zhvillim i rëndësishëm i hap rrugën organizimit të Konferencës Ndërqeveritare në muajt në vijim, duke përmbyllur hapjen e të gjithë kapitujve të negociatave me Shqipërinë.

Ky vendim konfirmon vlerësimin e BE-së për përgatitjen teknike, institucionale dhe ekonomike të Shqipërisë, si dhe angazhimin e saj ndaj perspektivës evropiane. Rëndësia e Grup-kapitullit 5 është thelbësor për ekonominë shqiptare, pasi përfshin fusha

kyçe për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm, mbështetjen e fermerëve dhe peshkatarëve, dhe sigurinë ushqimore.

Grup-kapitulli 5 përbëhet nga 5 kapituj: Kapitulli 11 (Bujqësia dhe Zhvillimi Rural); Kapitulli 12 (Siguria Ushqimore, Politika Veterinare dhe Fitosanitare); Kapitulli 13 (Peshkimi); Kapitulli 22 (Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore) dhe Kapitulli 33 (Dispozitat financiare dhe buxhetore).

Negociatat e këtij grup-kapitulli do të nxisin reforma për modernizimin e bujqësisë, përmirësimin e standardeve të prodhimit ushqimor dhe forcimin e politikave të kohezionit.

Shqipëria synon të hapë të gjithë kapitujt e negociatave gjatë vitit 2025 dhe të përfundojë negociatat e anëtarësimit deri në fund të vitit 2027, me synimin për t'u anëtarësuar në BE deri në vitin 2030.

“

Ky vendim konfirmon vlerësimin e BE-së për përgatitjen teknike, institucionale dhe ekonomike të Shqipërisë, si dhe angazhimin e saj ndaj perspektivës evropiane. Rëndësia e Grup-kapitullit 5 është thelbësor për ekonominë shqiptare, pasi përfshin fusha kyçe për zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm, mbështetjen e fermerëve dhe peshkatarëve, dhe sigurinë ushqimore.

”

SHBA-ja dhe BE-ja arrijnë marrëveshje për tarifatat doganore

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian arritën një marrëveshje për tarifatat doganore të dielën, pas një takimi të shkurtër mes presidentit amerikan, Donald Trump, dhe presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Kjo marrëveshje vjen vetëm disa ditë para përfundimit të afatit të vendosur nga Shtëpia e Bardhë për vendosjen e tarifave ndëshkuese ndaj importeve nga BE-ja, e cila përbëhet nga 27 vende anëtare dhe është partneri më i madh tregtar i SHBA-së.

“Ishte një negociatë shumë interesante. Mendoj se do të jetë e shkëlqyer për të dyja palët”, tha Trump.

Bisedimet kishin për qëllim të shmangnin vendosjen e tarifave ndëshkuese – dhe hakmarrjen e paralajmëruar nga Evropa – që mund të trondisnin ekonominë në mbarë botën.

Trump dhe von der Leyen zhvilluan bisedime private në një nga fushat e golfit të Trumpit në Skoci dhe më pas dolën me një deklaratë të përbashkët, duke thënë se kishin arritur një marrëveshje “gjithëpërfshirëse”.

Para takimit, Trump e përshkroi marrëdhënien tregtare me BE-në si “shumë të njëanshme dhe të padrejtë ndaj SHBA-së”.

“Mendoj se çështja kryesore është ndershmëria. Ne kemi pasur një kohë shumë të vështirë me tregtinë me Evropën”, tha ai.

Von der Leyen tha se SHBA-ja dhe BE-ja përbëjnë së bashku bllokun më të madh tregtar në botë, që përfshin qindra milionë njerëz dhe trilionat dollarë në shkëmbime tregtare. Trump shtoi se përballë këtij potenciali, “vlen të



provohet të arrihet marrëveshja”. Presidentja e Komisionit Evropian e përshkroi Trumpin si “negociator të fortë”, ndërsa ai ndërhyri duke shtuar: “por i drejtë”. Von der Leyen shtoi se nëse arrihet suksesi, “kjo mund të jetë marrëveshja më e madhe që secili prej nesh ka nënshkruar ndonjëherë”. Për muaj të tërë, Trump ka kërcënuar shumë vende me tarifa të larta për të ulur deficitin tregtar të SHBA-së me partnerët kryesorë. Së fundmi, ai kishte sinjalizuar se çdo marrëveshje me BE-në do të duhej të reduktonte tarifën e planifikuar prej 30%.

Takimi u zhvillua pas ditës së dytë radhazi që Trump luajti golf në fushën e tij në Turnberry, i shoqëruar nga djemtë e tij, Eric dhe Donald Jr. Vizita pesëditore e Trumpit në Skoci është e përqendruar kryesisht në promovimin e pronave të tij të golfit.

Administrata amerikane kishte paralajmëruar se afati për vendosjen e tarifave nuk do të shtyhej më.

“Nuk ka më zgjatje, nuk ka më periudha faljeje. Më 1 gusht, tarifatat vendosen, dogana fillon

mbledhjen e të hollave dhe nisim”, tha sekretari amerikan i Tregtisë, Howard Lutnick, për “Fox News Sunday”.

